**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KESHILLI I MINISTRAVE**

**V E N D I M**
**NR.121 DATE 12.2.1996**

**P E R**
**DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN E KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.360, DATE 10.7.1995 "PER REGJIMIN E EKSPORT-IMPORTIT NGA DHE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE", NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.415, DATE 7.8.1995**

Me propozimin e Ministrise se Industrise, Transportit e Tregtise dhe te Ministrise se ujqesise dhe Ushqimit, keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr.360, date 10.7.1995, ndryshuar me vendimin nr.415, date 7.8.1995, ne piken 2 behen keto ndryshime :

- fjalet "dru zjarri" te zevendesohen me fjalet :

"Druri si lende djegese, ne kercunj, ne kopace, ne dege, ne shkarpa(apo) ne forma te ngjashme; druri ne ashkla apo ne copa; tallash dhe mbetje dhe kthime te drurit, nese jane apo jo te aglomeruara ne kercunj, briketa apo forma te ngjashme:

- fjalet"trupa druri te paperpunuar" te zevendesohen me fjalet lekura apo nga lengu, apo thjesht e rrumbullakosur";

- fjalet lende druri e sharruar dhe binare" te zevendesohen me fjalet "dru i sharruar apo i prere per se gjati, i prere ne feta apo ai qeruar, nese eshte apo jo zdrukthtuar, poliruar me shpan apo ngjitur nga kllapat bashkuese te nje trashesie me teper se 6mm";

2. Ne piken 2 shtohet nje paragraf me kete permbajtje :

"44.09 Drure(perfshire shiritat dhe pllakat per dysheme parketi, jo te bashkuara) te profiluar(bashkuar me gjuhez apo me pllaka, ne forme ulluqesh, ne forme shiritash, me fole apo me buze te zgavruara, bashkuar ne forme V, ne forme rruazash, te rrumbullakosura, apo ne forma te ngjashme) pergjate çdo nga anet apo faqet e tij, nese jane apo jo te zdrukthtuara, te polimeruara me shpan apo te ngjitur nga kllapat bashkuese".

Ky vendim hyn ne fuqi ne daten 15 mars 1996.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI